



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

09-03-2022

Prokuror / Prokurorja	Numri/Çmimi	Shënim	Vlera
	02-035/02	257	



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale 03/L-040 Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr 28/2008 dhe nenit 51, paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, dhe nenit 19.2 të Rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për varreza, mirëmbajtjen e tyre dhe shërbimet e varrimit në territorin e Komunës së Vitisë nr 01-013/1962 të datës 30.12.2014, Kryetari i Komunës së Vitisë bien këtë:

V E N D I M
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE NË SHUMË PREJ
2,600.00€ KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË VITI

Neni 1.

Kryetari i Komunës së Vitisë, ndan mjetet financiare në shumë 2,600.00€ (dymijë e gjashtëqind euro) Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti në emër të shërbimeve të varrimit për persona të vdekur në Komunën e Vitisë.

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi derdhen në llogari të Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti në llogarinë 17-02-001600083743.

Neni 2.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është regjistri i shërbimeve të varrimit nga Këshilli i Bashkësisë Islame të Komunës së Vitisë prej 01.09.2021 deri më datë 08.09.2021 për 20 persona të vdekur (nga numri 1 deri 20 i faturës). Numri i faturës nr 88/22 të datës 22.02.2022

Mjetet nga neni 1 i këtij vendimi sigurohen nga buxheti i Komunës së Vitisë për vitin 2022 nga kodi për subvencione i zyrës së Kryetarit të Komunës së Vitisë.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e thesarit e Komunës së Vitisë.

Neni 4.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

- 1.K.B.I-Viti
2. Zyrës së Thesarit
3. Zyrës së Kryetarit
4. Arkivit

KRYETARI I KOMUNËS SË VITISË

Sokol Haliti

